



**AS-Audit Services sh.p.k**  
Adresa: Rr. "Kosovarëve", Nd.35, H.2, Ap.7  
Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë  
Mobil: 069 20 99 204  
E-mail: afrim.suli@outlook.com

**RAPORT I MONITORIMIT TE FUSHATES ZGJEDHORE VENDORE 2019**  
**PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE (ADK)**

**Pala Angazhuese: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Pala Përgjegjëse: PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPERISE (ADK)**

**Nëntor 2019**

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje, informacion i përgjithshëm.....	3
Angazhimi, objekti dhe qellimi	
Të dhëna mbi subjektin dhe fushatën zgjedhore	
Identifikimi i kriterëve të matjes dhe vlerësimit .....	9
Kritereret e vlerësimit, baza ligjore dhe rregullatore	
Metodologjia e monitorimit	
Monitorimi i fushatës zgjedhore, përmbledhje e punës së kryer.....	12
Monitorimi i zyrave elektorale dhe aktiviteteve	
Monitorimi i dokumentimit të shpenzimeve të fushatës	
Përlogaritja e kostove të zyrave elektorale dhe aktiviteteve	
Monitorimi i respektimit të kufirit maksimal të shpenzimeve	
Monitorimi i rregullave të brendshme për raportimin e shpenzimeve	
Monitorimi i trasaksioneve financiare	
Kufizimet dhe vështirësitë e evidentuara gjatë procesit.....	32
Bazat për konkluzione, konkluzionet dhe rekomandimet.....	35

## I. Hyrje, informacion i përgjithshëm

---

### Angazhimi, objekti dhe qellimi

Në cilësinë e Ekspertit Financiar, jam angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në misionin e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore vendore 2019 të Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë(ADK), në bazë të kontratës së shërbimit nr. 5072 datë 01.06.2019.

Në mënyrë të sintetizuar qëllimi dhe objektivat e monitorimit janë dhënë në Udhëzimin e KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiare", nenin 3, sipas të cilit ekspertët financiar të emëruar sipas këtij udhëzimi duhet të monitorojnë në mënyrë specifike:

- a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- d) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- e) Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- f) Trasaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e trasaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Në tërësi monitorimi i procesit zgjedhor përfshin vëzhgimin dhe mbledhjen e informacioneve financiare dhe jo-financiare që lidhen me zbatimin e dispozitave ndaluese dhe kufizuese nga subjekti zgjedhor gjatë zhvillimit të fushatës, verifikime të informacioneve financiare historike, të shprehura specifikisht në udhëzimin e sipërcituar, si dhe analiza e tij për të vlerësuar shkallën e pajtueshmërisë me kërkesat e akteve ligjore e nenligjore zgjedhore, kryesisht në aspektin financiar.

Periudha e kryerjes së monitorimit të procesit zgjedhor, për të cilën do të bëhet matja dhe vlerësimi, fillon me nënshkrimin e kontratës, datë 01 Qershor 2019, dhe mbaron në datën 30 Shtator 2019. Por gjithashtu, pjesë e monitorimit do të jetë dhe periudha para lidhjes së kontratës, tre muaj para datës së zgjedhjeve për trasaksionet e kryera në shërbim të fushatës zgjedhore të subjektit.

Në përputhje me termat e kontratës, raportimi i gjetjeve nga monitorimi në terren është bërë nëpërmjet dy raporteve të ndërmjetme, të cilat i janë dërguar KQZ-së sipas afateve të përcaktuara dhe mbyllet me raportin përfundimtar të monitorimit që do të lexoni në vijim, i

cili është ndërtuar në përgjigje të pikave të kërkuara nga Udhëzimi i KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017.

### **Të dhëna mbi subjektin dhe fushatën zgjedhore**

Fushata zgjedhore për zgjedhjet vendore ka filluar zyrtarisht më 31 Maj 2019 dhe ka përfunduar me ditën e zgjedhjeve 28 Qershor 2019.

Nga të dhënat e publikuara dhe ato të dërguara nga KQZ për ekspertet financiar, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë(ADK) është paraqitur në këto zgjedhje si pjesë e Aleancës për Shqipërinë Europiane dhe në të gjitha bashkitë mbështet kandidatin e përbashkët të këtij grupimi. Ajo ka depozituar dhe deklaruar lista shumëemërore për këshilltarë bashkiakë në 25 bashki nga 61 bashki gjithsej.

Nga informacioni që siguroam nga drejtuesi i Partisë, rezulton se organizimi dhe zhvillimi i fushates është i përcaktuar si një mbështetje e përgjithëshme ndaj Aleancës për Shqipërinë Europiane, pa hapur zyra elektorale dhe pa organizuar aktivitete zgjedhore në emër të partisë, si ne rang kombëtar dhe lokal. Këshilltarë bashkiakë të listave shumëemërore mund të zhvillojnë aktivitete të veçuara në zonat e tyre të kandidimit.

Si pjesë e informacioneve të marra nga partia është dhe një deklaratë, në të cilën përshkruhet mungesa e aktiviteteve partiake dhe e kryerjes së shpenzimeve dhe e marrjes së të ardhurave për qëllime të fushatës zgjedhore.

Gjatë periudhës së funksionimit normal të partisë kryerja e punëve të përditëshme mbështetet në punën vullnetare të anetarëve dhe simpatizantëve të saj, ajo nuk ka të punësuar të regjistruar. Dhe po ashtu dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për të ardhurat dhe shpenzimet realizohet nga vullnetarë.

Mbi këto të dhëna, u hartua programi monitorimit dhe për të siguruar evidencën e nevojshme dhe të pershtatshme, ne kemi përcaktuar gjithashtu dhe metodologjinë e monitorimit, metodat dhe procedurat e sigurimit të saj.

## **II. Identifikimi i kriterëve të vlerësimit dhe metodologjia e monitorimit**

### **Kriteret e vlerësimit, baza ligjore dhe rregullatore**

Kriteret e monitorimit, kundrejt të cilave do të vlerësohet dhe matet shkalla e përputhshmërisë së fushatës zgjedhore me aktet ligjore dhe rregullative burojnë nga:

- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,
- Ligji nr. 8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017,
- Udhëzimi i KQZ-së, Nr.1, date 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushates zgjedhore",
- Udhëzim i KQZ-së, Nr.2 date 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiar"

- Udhëzimi i KQZ-së, Nr.3 date 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të perdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".
- Ligjin për kontabilitetin dhe standardet kontabël përkatëse, etj.

### **Metodologjia e monitorimit**

Në kushtet e deklarimeve të drejtimit të Partisë, se ajo në funksion të fushatës zgjedhore nuk do të organizonte asnjë aktivitet elektorale në gjithë teritorin dhe se nuk kishte parashikuar burime për sigurimin e të ardhurave dhe kryejn e shpenzimeve, monitorimi u orjentua në këto drejtime:

- Sigurimin e informacionit paraprak për fushatën, kërkuar drejtuesve të Partisë, si palë përgjegjëse, për të na informuar rreth organizimit të fushatës zgjedhore dhe kryesisht për çështjet që lidhen me: listen e zyrave elektorale dhe adresat e tyre në të gjitha bashkitë; listen e aktiviteteve, vendet dhe datat e zhvillimit të tyre; listen e bashkive të njoftuara nga Partia për hapjen e zyrave elektorale; kontratat me entitete tregtare për blerje mallrash e shërbimesh etj.
- Monitorimin e drejtpërdrejtë në terren, nëpërmjet procedurave të vëzhgimit, inspektimit, për të evidentuar përputhjen e deklarimeve të partisë me atë që ndodh në fakt gjatë procesit zgjedhor.
- Analiza dhe sinteza e të dhënave të mbledhura gjatë monitorimit dhe të siguruara nga raportimet financiare dhe jo-financiare, për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me kriteret ligjore apo kriteret e tjera.

## **III. Monitorimi i fushatës zgjedhore, përmbledhje e punës së kryer**

---

### **1. Monitorimi i zyrave dhe aktiviteteve zgjedhore në teritor**

Paralelisht me kërkesat për informacion drejtuar subjektit zgjedhor ne filluam vëzhgimet dhe inspektimet në terren, ku fokusi i monitorimit ishte ekzistenca e zyrave elektorale dhe e aktiviteteve elektorale të organizuara nën siglën e partisë, dhe me objektiv:

- Mbledhjen dhe raportimin e gjetjeve që kishin të bënin me kontrollin e zbatimit të ndalimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në Udhëzimin Nr.1 ,datë 31.05.2017 të KQZ-së, i cili kërkon që: përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike të jetë në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor dhe, subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat.
- Sigurimin e informacionit financiar dhe jo financiar dhe lidheshin me shpenzimet e destinuara për fushatën, dhe kryesisht në evidentimin e elementëve të kostove të zyrave dhe aktiviteteve, llojin dhe madhësitë e ambienteve, sasi të materialeve publicitare të pëdorura, dokumentimin e shpenzimeve me fatura blerje etj, të dhëna që do të perdoren për evidentimin dhe matjen e kostove e fushatës.

Ashtu siç është raportuar në raportet e ndërmjetme, rezultatet e monitorimit sipas rajoneve dhe/ose bashkive të monitoruara paraqitën si vijon:

#### Për periudhën 01-10 Qershor 2019

Nr	Bashkitë e monitoruara ne terren	Evidenca e marrë-gjetjet, 1-10 Qershor 2019		
		Ekzistenca e zyrave	Aktivitetet zgjedhore	Materiale të fushatës të ndaluara
1	Krujë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
2	Durrës	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
3	Shijak	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
4	Kamëz	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
5	Tiranë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
6	Divjakë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate

#### Për periudhën 11-16 Qershor 2019

Nr	Bashkitë e monitoruara ne terren	Evidenca e marrë-gjetjet, 11-16 Qershor 2019		
		Ekzistenca e zyrave	Aktivitetet zgjedhore	Materiale të fushatës të ndaluara
	Kukës	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Kurbin	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Librazhd	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Prrenjas	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate

#### Për periudhën 17-23 Qershor 2019

Nr	Bashkitë e monitoruara ne terren	Evidenca e marrë-gjetjet, 17-23 Qershor 2019		
		Ekzistenca e zyrave	Aktivitetet zgjedhore	Materiale të fushatës të ndaluara
	M.Madhe	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Vau Dejë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Pukë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Fushë Arrës	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate

**Për periudhën 24-28 Qershor 2019**

Nr	Bashkitë e monitoruara ne terren	Evidenca e marrë-gjetjet, 24-28 Qershor 2019		
		Ekzistenca e zyrave	Aktivitetet zgjedhore	Materiale të fushatës të ndaluara
	Mat	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Klos	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Bulqizë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Dibër	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Kolonjë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Përmet	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Këlcyrë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Gjirokastrë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate
	Libohovë	Nuk jane gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivite	Nuk ka publicitet fushate

**Në përmbledhje të katër periudhave, gjetjet dhe shkeljet e identifikuar gjate monitorimit ne terren janë:****Për zyrat elektorale**

Në bashkite e monitoruara në terren nuk u evidentuan zyra elektroirale që përdorshin nga partija ADK.

**Për aktivitetet zgjedhore**

Nuk u evidentuan aktivite të organizuara nga partia ADK për gjithë periudhën zgjedhore.

**Për pëdorimin e materialve të ndaluara**

Nuk u evidentuan në asnjë rast materiale me natyrë publicitare dhe propagandistike dhe kosto të mundëshme me natyrë zgjedhore.

**Pë emisione televizive dhe spote në shërbim të zgjedhjeve**

Nga ndjekja e emisioneve në radio e televizion per periudhe 24-28 Qershor, kryetari i partisë ka qenë pjesmarrës në një emision televiziv te Ora News në funksion të fushates zgjedhore te partisë. Nga informacionet që morëm nga drejtuesi i partisë kjo paraqitje nuk shoqërohet me pagesa, dhurime dhe shpenzime për fushatën.

## **2. Monitorimi i dokumentimit të shpenzimeve të fushatës**

Një nga kerkesat e udhezimit të KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017, drejtuar ekspertëve, është detyrimi për të monitoruar dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor. Nga inspektimi dhe verifikim i dokumentacionit kontabël, rezultoi se subjekti zgjedhor për fushatën elektorale 2019 nuk ka realizuar asnje blerje mallrash dhe shërbimesh.

## **3. Përlllogaritja e kostove të zyrave elektorale dhe aktiviteteve**

Për mungesë të veprimtarive dhe aktiviteteve zgjedhore, përlllogaritja e kostove të tyre nuk është e aplikueshme.

## **4. Monitorimi i respektimit të kufirit maksimal të shpenzimeve**

Për mungesë të veprimtarive dhe aktiviteteve zgjedhore, të shpenzimeve dhe të ardhurave, nuk është e aplikueshme kërkesa rregullore për respektim të kufirit të shpenzimeve.

## **5. Monitorimi i rregullave të brendshme për raportimin e shpenzimeve**

Sistemi i organizimit të informacionit financiar, mbi të cilin duhet të mbështetet raportimi financiar (vjetor apo i ndermjetem), është i organizuar në seline e partisë dhe realizohet nga punonjës vullnetar. Por, siç u tha dhe më lart, duke qënë se gjatë monitorimit nuk është konstatuar asnjë transaksion ekonomik dhe financiar, nuk mund të gjykosh mirfunksionimin e sistemit të raportimit dhe rregullave të brendshme të partisë.

## **6. Monitorimi i trasaksioneve financiare**

Në kërkim të monitorojmë trasaksionet financiare për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, të kryera nga Partia me persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e trasaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike. Por dhe për këtë çështje nuk ka gjetje e konkluzione për mungesë të plotë trasaksionesh.

## **IV. Kufizimet dhe vështirësitë e evidentuara gjatë procesit**

---

Procesi i monitorimit të fushatës filloi një ditë pas nisjes zyrtare të saj, 31 Maj 2019. Por siç dihet fushata për zgjedhjet vendore 2019 u zhvillua në një mjedis të pafavorshëm për një fushatë normale dhe konkurruese.

Për këtë shkak, në pritje të zhvillimeve të reja, dhe vetë partia që kishim në monitorim nuk kishin një plan veprimi të gatshëm për zhvillimin e fushatës. Në këto kushte, siç është thënë dhe më lart, monitorimi u fokusua nga vëzhgimet dhe inspektimet në terren.

Po ashtu një veçori e kësaj fushate ishte se aktivitetet në mbështetje të kandidatëve u orientuan kryesisht në mediat sociale apo në takime të vogla me zgjedhësit, e cila vështirëson ndjekjen, dokumentimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kalkulimin e kostove.



## V. Bazat për konkluzione, konkluzionet dhe rekomandimet

Ne kryem monitorimin e shpenzimeve të fushatës për zgjedhjet vendore 2019 të Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë(ADK), në përputhje me standardet profesionale dhe përgjegjësitë e përshkruara në mënyrë më të detajuar në kontratën e angazhimit. Ne jemi të pavarur nga pala përgjegjëse në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për angazhime të tilla, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca që kemi siguruar gjatë monitorimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për konkluzionin tonë, brenda një sigurie të kufizuar.

### Konkluzionet:

Në përputhje me objektivat e monitorimit që jënë dhënë në Udhëzimin e KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017, mbështetur në punën tonë përshkruar në këtë raport, konkluzionet tona për secilën çështje janë si vijon:

- a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 dhe në Udhëzimin Nr.1 ,datë 31.05.2017 të KQZ-së;

*Gjatë monitorimit nuk u konstatuan shkelje të dispozitave ndaluese mbi përdorimin dhe afishimi i materialeve propagandistike dhe vendosjen dhe vendosjen e zyrave elektorale.*

- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;

*Gjatë monitorimit nuk u konstatuan shmangje në zbatimin e kritereve e vendosura nga legjislacioni zgjedhor, kontabël dhe tatimor për dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës.*

- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;

*Gjatë monitorimit, nuk u konstatuan shmangje nga kërkesa e Kodit Zgjedhor se shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike....buxheti shtetit..*

- d) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;

*Gjatë monitorimit nuk u konstatuan aktivitete zgjedhore dhe hapje zyrash elektorale dhe për rrjedhim kalkulimet e kostove janë të paaplikueshme.:*

- e) Rregullat e brendshme të subjektit elektorale për raportimin e shpenzimeve;

*Nga monitorimi dhe deklarimet e drejtuesve të Partisë, rezulton se sistemi e informacionit*

*financiar dhe raportimit është i ndërtuar dhe realizohet nga vullnetare por për mungesë të transaksioneve nuk mund të gjykohet për funksionimin e tij.*

- f) Trasaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e trasaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

*Bazuar në punën tonë përshkruar në këtë raport, nuk konstatojm transaksione të pajustificuara dhe burime të ardhurash në kundërshtim me kufizimet e legjislacionit zgjedhor.*

### **Rekomandime**

Ne nuk kemi rekomandime specifike për aktivitetin elektoral të partisë ADK, sepse siç është paraqitur në raport, jemi në kushtet e mungesës së plotë të aktiviteteve dhe transaksioneve financiare në funksion të fushatës elektorale.

Ndërsa për procesin e monitorimit, mendojmë se do të ishte efektive për kontrollin e zbatimit të ndalimeve dhe kufizimeve të kerkuara nga legjislacioni zgjedhor, që partitë para fillimit të fushatës, të raportojnë zyrtarisht në KQZ projektin e plotë të fushatës sipas një formati të miratuar, i cili të përmbajë të dhënat për zyrave elektorale, aktivitetet që parashikohen të zhvillohen, elementët e kostove shoqeruese të tyre dhe burimet e parashikuara të mbulimit me fonde (mjetet e veta, buxheti i shtetit apo donacione).

### **Eksperti Financiar**

**Afrim Suli**



**Tiranë, më 22 Nëntor 2019**